

Programi për Stabilizim të Komuniteteve V (EU-CSP V)

Thirrje Publike për Projekt Propozime

Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) vazhdon me implementimin e Programit për Stabilizimin e Komuniteteve (EU-CSP V), dhe të ofroj asistencë financiare dhe teknike për fillim të bizneseve të vogla apo zgjerim të atyre ekzistuese sidomos të atyre bizneseve që promovojnë dhe forcojnë reintegrimin e qëndrueshëm të anëtarëve të kthyer të komuniteteve jo-shumicë. Projekti EU-CSP V poashtu do të vazhdoj të përkrah edhe iniciativat e komunitetit prej të cilave komuniteti do të ketë përfitim më të gjërë duke punuar me pjesëtarët e komunitetit dhe fermerëve individual dhe prodhuesëve për të eksploruar mundësitë për aktivitete të përbashkëta përmes krijimit dhe mbështetjes së asociacioneve të biznesit të komuniteteve jo shumicë dhe ato ndëretnike.

Programi për Stabilizimin e Komuniteteve (EU-CSP V), SHPALL THIRRJEN PËR PROJEKT PROPOZIME të ndërmarrësve të ardhshëm dhe ekzistues si dhe të grupeve e asociacioneve PËR PROJEKTE INDIVIDUALE DHE TË KOMUNITETIT. EU-CSP V do të financojë bizneset dhe projekte per komunitet që mund të dëshmojnë realizueshmëri dhe qëndrueshmëri ekonomike dhe që ofrojnë mundësi punësimi e krijim të të ardhurave.

Për udhëzime dhe fletë-aplikacione aplikantët e interesuar inkurajohen për të vizituar uebfaqen e IOM-it www.kosovo.iom.int si dhe në:

Tel: **049 968 486** dhe email: acavolli@iom.int (per komunat: *Pejë/Peç, Istog/Istok, Klinë/a, Gjakovë/Dakovica, Deçan/Deçane, Junik, Skenderaj/Srbica, Mitrovicë/a, Mitrovicë e Veriut/Northern Mitrovica, Leposavić/q, Zubin Potok dhe Zvečan/Zveqan*).

Në këto adresa, poashtu mund të merrni më shumë informata për procesin e aplikimit dhe zhvillim të biznes planeve, formularë për aplikim si dhe ndihmë se si duhet të bëhet plotësimi i formularëve si dhe informata tjera për procesin dhe udhëzimet e aplikimit.

Afati i fundit për dorëzim të aplikacioneve në email adresën acavolli@iom.int është **30 Qershor 2024** por aplikantët inkurajohen që t'i dorëzojnë aplikacionet e tyre sa më parë.